VENDIM
Nr. 114, datë 3.6.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ZENINA" SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E ASETEVE FIKSE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, germa "b" të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1618/3 prot., datë 29.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Zenina' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të paluajtshme të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve",

konstatoi se:

- Më datë 28.4.2025, shoqëria "Zenina" sh.p.k., e licencuar nga ERE për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 25, datë 27.1.2025, të Bordit të ERE-s, ka paraqitur kërkesë pranë ERE-s për konfirmim dhe udhëzime në lidhje me marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve fikse dhe barrësimin e kuotave të saj, në funksion të marrëveshjeve të lidhura me "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a.

- Në përgjigje, ERE ka sqaruar se, në zbatim të pikës 1 të nenit 44 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe të nenit 4, germa "b", të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin nr. 119, datë 21.7.2016, të Bordit të ERE-s, miratimi nga ERE kërkohet vetëm në rastet kur vlera e aseteve tejkalon shumën 150.000.000 lekë.

- Pas depozitimit të dokumentacionit nga ana e shoqërisë, konstatohet se vlera e aseteve që kërkohen të transferohen është nën kufirin e përcaktuar në kuadrin rregullator më sipër cituar. Për rrjedhojë, vlerësohet se kërkesa nuk është objekt i shqyrtimit nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Zenina" sh.p.k. për dhënien e autorizimi nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj "Intesa SanPaolo Bank Albania" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Zenina" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti